



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Komunikimi Turistik B

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë mësimore: 30 leksione / 30 seminare

Viti / Semestri: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i shkencave në “Komunikim Ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike mbi komunikimin në fushën e turizmit, me fokus të përdorimi i materialeve promovuese dhe teknikat e marketingut turistik. Të zhvillojë kompetencat e studentëve për të kuptuar dhe analizuar ligjërimin turistik në forma të ndryshme, të shkruara dhe të folura. Të aftësojë studentët në ndërtimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe institucionale në kontekste profesionale të turizmit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Studentët do të njohin dhe konceptojnë materiale promovuese turistike si broshura, katalogë, itinerare dhe komunikime online.
2. Studentët do të mësojnë të analizojnë dhe të përdorin lloje të ndryshme të ligjërimin turistik për qëllime të marketingut dhe ndërveprimit me klientët.
3. Studentët do të aftësohen për të kuptuar nevojat e klientëve, për të përdorur strategji efektive komunikimi dhe për të bashkëpunuar me aktorë të ndryshëm në sektorin turistik.

Rezultatet e pritshme:

1. Aftësinë për të ushtruar mendim analitik, kritik dhe kreativ në interpretimin e materialeve të ndryshme promovuese turistike.
2. Aftësinë për të bërë studime sipas rastit dhe për të përpunuar informacione dhe materiale të fushës.
3. Aftësinë për të kryer punë në terren duke zbatuar mjetet e metodologjisë kërkimore.
4. Aftësinë për të qenë një profesionist në përdorimin e strategjive të komunikimit në funksione të ndryshme në fushën e turizmit.